

**GAZMEND MAHILI**

LARGËSI TË KALTRA

TREGIME DHE NOVELA

---

**BOTIMET TOENA**



GAZMEND MAHILI

LARGËSI TË KALTRA

tregime dhe novela

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2016

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktorë: Korab Hoxha, Kujtim Dashi

Korrektore: Petrina Ago

Përkujdesja grafike: Albana Kuraj Gega

Kopertina: Ana Shema

ISBN 978-9928-205-55-1

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

Botimet TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

## PARATHËNIE

Vëllimi me tregime e novela “Largësi të kaltra”, që po ia paraqesim lexuesit, është libri i tretë i Gazmend Mahilit; dy të parët, të botuar respektivisht në vitin 1995 “Madhështia e mbrapshtë” dhe në vitin 2000 “Humbësit e dëshirave”. Pra, si shihet, në një kohështrirje relativisht të gjatë nga njëri vëllim te tjetri. E themi këtë jo për evidencë, porse gjykoj që, në rastin më të mirë, mund të presupozohet e, pse jo, tashmë të bindemi, se me gjithë angazhimet e panumërta si çdo shqiptar i larguar, Gazmendi gjen kohë t’i përkushtohet me seriozitet pasionit, për çka dëshmon se kemi të bëjmë me një autor të talentuar dhe me kërkesa ndaj letërsisë që shkruan, e cila lexohet vërtet me ëndje.

Përkitazi e përmenda këtë fakt, për të vënë në dukje se s’kemi të bëjmë me një botim premierë dhe me promovimin e një autori të ri, përkundrazi të një kolegu të ri, të cilit me gjithë zemër le t’i themi: “Mirë se na erdhe, koleg i nderuar!”. Nëse do t’i përfshinim për arsye studimi në ndonjë kolanë krijimet e autorëve shqiptarë, që ashtu si Mahili krijojnë në vend të huaj dhe jashtë qarqeve e mjediseve letrare të vendit

të tyre, ajo do të quhej “Letërsi e (mirëfilltë) e pasviteve ’90”, e cila na vjen nga vende të ndryshme të Europës.

Vëllimi “Largësi të kaltra” përfshin dy novela: “Largësi të kaltra” dhe “Melodi e një dashurie të ndërprerë”, - kjo e fundit, mbase, më e realizuara dhe më e bukura e librit, me një theks aktual, sidomos në kushtet e sotme të Shqipërisë, paçka se ngjarjet zhvillohen në një vend më të civilizuar, *“sidoqoftë me 35 mijë banorë, numër banorësh i pandryshuar qysh se është krijuar qyteti”* (nënvizon autori), me sens universal, ku vihen përballë njëri-tjetrit individi dhe komuniteti ku jeton, mentalitetet e raportet në mes të tyre kur është fjala për dashurinë, për ndryshimin në tërësi, për një jetë ndryshe, jorutinore e monotone, për të gëzuar jetën dhe lirinë - si dhe tri tregime, respektivisht: “Gjahtari i shkretëtirave”, “Dashuri fatale” dhe “Parandjenja”.

Këtë renditje e bëra enkas, për të shprehur më parë disa konsiderata për këto tregime, sidomos dy të parat. Pa hyrë në ritregimin e fabulës a veçori të tjera artistike, dua të nënvizoj faktin se këto dy tregime janë shkruar në vetën e dytë. Tregimi a proza në tërësi në vetën e dytë, si dihet, është ndër më të vështirat në narracion dhe, si e tillë, më pak e praktikuar nga autorët që preferojnë të shkruajnë zakonisht në vetë të parë dhe të tretë. Përvoja e autorëve të huaj, e më pak atyre shqiptarë, që e kanë përdorur, tregon se ky procedim narrativ, kërkon mjaft kulturë të shkruari, përvojë, përgjegjshmëri për autorin, kërkon përqendrim e mjeshtëri të lartë për ta mbajtur vëmendjen e lexuesin të lidhur me veprën, qoftë tregim, novelë a roman, për të dhënë fabulën, temën dhe portretizuar e individualizuar personazhet. Autori ia ka dalë mbanë, aq më tepër kur vihet

re edhe njëfarë prirje lirike-filozofike, sidomos në tregimin “Dashuri fatale”, por edhe në tjerat.

Në përpjekjet e lavdërueshme të autorit për një letërsi të kohës e moderne, çka e ndihmon dhe kontakti i tij me letërsinë bashkëkohore, ku jeton e punon, ndeshemi edhe me kërkime të suksesshme, me fraza e me një stil racional e lakonik si të ertetë, por me një konsolidim të brendshëm, ndeshemi me metafora, antiteza dhe pyetje retorike të panumërta, që e bëjnë prozën e tij dinamike e të shkathët dhe krijojnë një kohezion tekstual të veçantë e origjinal, aq sa të krijohet përshtypja se ashtu si te “Reja” - një nga veprat më të njohura të instalacionit të artit publik ideuar nga artisti i mirënjohur japonez Sou Fujimoto - *në prozën e Mahilit, nën këtë “re” a veshje mjeshtërore artistike të jashtme, lëvrin një jetë e gjallë dhe e ndryshme nga bashkëkohësit e kolegët e tij, që vlen të merret në konsideratë për risinë që sjell.*

Nëse do të ndaleshim te karakteret më të realizuara të librit, që të mbeten në mendje së bashku me fatin e tyre, pa ngurrim mund të veçoja Geslanda Grasia, Françeskën teksa lexon në gjyq ditarin që ka lënë Geslanda Grasia e vetëvrarë, si viktimë e mjedisit konservator të qytetit me “35 mijë banorë, numër banorësh i pandryshuar qysh se është krijuar qyteti”.

Më vjen mirë që m’u dha rasti t’i bëj urimin e sinqertë: “Mirë se na erdhe, koleg i nderuar!”.

**Kujtim Dashi**





## GJAHTARI I SHKRETËTIRAVE

Nuk kishte hollësi që mund të të shpëtonte. Ti duhej ta kapje çdo imtësi qoftë dhe me një vijë të vetme. Të të themi se ishte e përbindshme s' do ta besojë. Mos u çudit, as vetë ti s' e dije se çfarë do të dilte prej saj, megjithatë vazhdoje drejt shkretëtirës.

Gjeje prehje dhe ëmbëlsi. Ndieje atë vorbull të papërshkrueshme, atë histerizëm që përbënte thelbin. Dhe, në fund të çdo dite, shkruaje ca fjalë të përmbledhura në një rresht të vetëm: “Mos e vrisni marrëzinë!”. Po ç'kërkoje ti? Mos vallë që marrëzia të pushtonte gjithçka? Mbizotërimi i saj pluskonte mes së pakuptueshmes. As ndjellakeq s' mund të bëheshe.

Gruaja të foli nga tualeti ku ishte zhveshur për të bërë një banjë me qumësht. Ti adhuroje butësinë shkrirëse. E vetmja që të mashtronte përpara nisjes. Nuk doje t'ia dije se nganjëherë ndër vite ka edhe ngërdheshje dashurie.

A nuk do të të hanin ata qen, të cilët të dukeshin si viktima? Sa kohë do të zbaviteshe duke parë trupat që shqyheshin dhe gjakun që rridhte? Dhe sërish, kur vinte koha, ti vështroje

qentë që shtoheshin. Qeshje dhe, vetvetiu, të vinte mendimi: “Do të hani një ditë vetveten”. Krenoheshe për përfytyrimet e tua për largësinë, merrje lapsin dhe përqendrohesh mbi letrën e bardhë e të madhe.

Vendose të skicoje një qen me përmasa kolosale. Si duket, ai duhej t’i hante të gjithë qentë e tjerë, apo çfarë? Me dhëmbët e tij të kaltër do të sillte kobin e tyre. Ndofta ky vegim mund të zbërthente shëtitjet e tua të përhumbura. Ndoshta ripërtëritja s’kishte më vend. A nuk e shihje trishtimin e pafundësisë? Nëse kishe përballë kundërshtimin, pse atëherë ngulmoje në këtë fund të paqenësishëm? Prapësimi i tigrin nuk ndodhi e, atëherë, si do të mund të ndodhte kjo me ty?

Qetësia të mbushte me pritje. Pritja të torturonte me ëmbëlsi. Ëmbëlsia të joshte me ankth. Po qeni i kaltër duhej pikturuar. Ti pyete veten, nëse ideja përbënte një mrekulli. A do të pyeste mrekullia për arritjen? Ah, të kishe mundësi të shpëtoje! Jo. Jo. Katastrofa do ta mbërrinte rezultanten.

Gruaja po rrëshqiste si mes ëndrrës. Hedhja e flokëve pas, e shoqëruar me një shpupuritje, i kthente diçka më tepër se freski. S’ ishte aspak befasi që ajo do të hynte në dhomën tënde e lakuriqësuar deri në brishtësi. Dhe ajo për pak, sa nuk harroi kontrollin në pasqyrën e madhe. Vështrimi, çuditërisht, s’iu ndal në asnjë pikë tjetër, përveç seksit.

A nuk e meritonte një piramidë pas vdekjes? E keqja s’ka për t’u shndërruar kurrë dhe kush mund ta kuptojë këtë. O brutalitet, as përmasat e tua nuk mund të përcaktohen.

Si ngjizet një çudi njerëzore? A shuhet në përkohësi, apo mbetet misterioze? Labirinti përherë të ngatërron. Të kesh fatin e habitshëm ta takosh këtë ngatërrim.

Gruaja nuk dha asnjë shenjë e s’bëri asnjë përpjekje kur të pa të vrrarë. Ajo vërejtja më tepër letrën e bardhë e të madhe

në mes të së cilës ishin ravijëzimet e një qeni të stërmadh e të kaltër, kurse përreth ca qen të zinj më të vegjël, që e kishin rrethuar. A thua të të kishin ngrënë ata?

Ajo, pas përhumbjes, u përmend pa trishtim dhe keqardhje: “Kështu ndodh kur gjuan nëpër shkretëtira”, tha.  
U kthye për t’u veshur.

*Paris, 2007*

## DASHURI FATALE

Udhëtimi yt i fundit. Ti e kishe parandier. Para tij bëre një shëtitje. Të tjerët të shoqëronin pa e kuptuar. Ti ua fshihje të gjitha. Dhe ata mbeten përgjithnjë në shkretëtirën e ëndrrave të tua.

Pse s' u përgjigjesh? Ata duan të të pyesin. S' mundesh? Përse? Gjithë jeta jote rrodhi pa kuptim, në një largësi, që u bë lumturia jote, a thua se kishe harruar se ç'po ndodhte me ty, se kishe vetëm një jetë. A e kishe dëgjuar një zë? Kthehu! Nga të ktheheshe? Ku të shkoje? Përse? A do të kishte një drejtim të paracaktuar? E ndieje se diçka po trokiste, ndaj e përcaktove më se i vetëdijshëm humbjen tënde. Shpresojë të arrije? Ti duhej të arrije, por, krahas vullnetit të hekurt, të mbyti melankolia. Po atëherë pse nuk e hidhje më larg vështrimin? Mos vallë t' u errësuan sytë?

A munde ta përjetoje në thellësi, për herë të fundit, në mënyrë të menjëhershme, atë që mbartje përherë në qenien tënde? Apo ajo të përfshiu dalëngadalë në kobin e saj madhështor? Ç'aromë kundërmonte? A e shijove atë?

Aventura jote ishte përtej kufijve të marrëzisë. A do të mund të triumfonte përpjekja jote nën heshtjen e përhershme? Pse s'i shqetësove të tjerët qoftë dhe një herë? Ndërsa përçmimi të kishte hedhur mantelin e tij të zi, ndërsa shkëlqimet e tua të përthyerë përhumbeshin në labirintin ku ishte nisur të kërkoje. Pavdekësia dhe vdekja do të të preknin. Ti dëgjoje kambanat e orëve të çmendurisë. I mbushur me dhembje pa cak, qëndroje përballë tërheqjes për nga humbëtira.

“Nëse një ditë nuk do të më shohësh më aty, përpara perëndimit të diellit, mendo se kam ikur pas tij, mendo se flatrat e engjëjve do të jenë prerë, se ylli i padukshëm në pafundësinë qiellore s'ka për t'u dukur kurrë më, se humbëtira do të thellohet, ndoshta më tepër se kaltërsia e syve të tu, se faqet e botës do të përmbysen si rrafshinat e shndritshme, se shpirtrat s'do të kenë më vend në parajsat hyjnore. Ndërsa lidhja e botës njerëzore me muzikën, do të bëhet vetëm me tingujt mortarë të një ceremonie me dhurata lulesh që s'njohin vyshkje”, kështu i shkruaje zonjushë Evisit.

Ajo merrte pamjen e një të mjere përpara frikës dhe ëmbëlsisë. Kujtonte fillimin, kur e mbulonte pavendosmëria. Dhe më tepër çuditej. Ku ishte forca e lumturisë te ti? Sepse jeta jote do të mbaronte që njëzet vjeç? Apo ku? Po gjithçka nisi tatëpjetën, pikërisht vetëm se ajo mendonte: “Edhe pak”.

Udhëtimi i fundit ishte i papërcaktuar nga forcat e rrjedhës jetësore. Fantazia jote, tmerrësisht e mjegulluar, kishte humbur vetëkontrollin. Truri yt i ndezur përfytyronte zjarrin në pikat e horizonteve. Tërheqja e fundit. S'mund ta kuptoje se cila ishte. Çfarë pëlqeve vallë për herë të fundit? A doje të thoshe diçka?

Ej, djalosh njëzetvjeçar! Ej, Genti, përse përfytyroje shkretëtirat? A mos humbe vallë ndjenjën për jetën? E bukura dhe e shëmtuara të kanë rrëmbyer? Ej, botë njerëzore! Të gjitha do të ishin të pranueshme, madje dhe aksidentet në kërkim të së pacaktuarës. Po pse pikërisht ndodhi kjo e fundit? Përse pikërisht në orën fatale u gjende i shtrirë në krevat me vështrimin e përhumur dhe me rrëkenë e lotëve anash cepave të syve, pranë veshit dhe gushës? Tingujt e muzikës pse ishin të tillë? Mos ndoshta ata ndikuan në këtë proces, që s'ka kthim prapa kurrë?

Muzikë, çfarë përhapje ti?

Ti ishe përgatitur shpirtërisht, saqë asnjë rrugë tjetër s'do të mundej të të largonte nga fataliteti. E mendoje të pakuptueshme. Gjithçka i kishte shërbyer kësaj fillese të skëterrës.

Fillesat e lotëve të tua po të shfaqnin madhështoren. Ti po kujtoje shokët. Autobusi ecte. Xhami përpara u vesh. Ja, t'u errën sytë. Diçka prekëse dhe dehëse, e ëmbël dhe njerëzore. Fundi i këtij ankthi. Lëvizje dhe rrezatime. Stuhi dhe beteja. Lule përtej idealit. Shkatërrim ose më mirë lartësim. Po truri yt punonte. Zemra jote ndiente. Qenia jote ruante ende nuanca të padukshme.

A do të mund ta kuptonin njerëzit se në ç'krim morën pjesë? A do të ngrihej qoftë dhe vetëm një herë ndërgjegjia e tyre ndaj vetvetes? A do të arrinte ajo së paku një vegim të vetëm përpara sakrifkimit për lumturinë e të tjerëve? Ti po shëtisje. Jo, po kush atëherë? Fantazia jote e çuditshme. Kishte qëndruar rastësisht në një trotuar. Një femër shkëputet nga ana tjetër, të afrohet. Vetëm e sheh. Ajo të qëllon fort me shuplakë. Jo, askush nuk po të godet. Ti po godet vetveten. Ti ke harruar ku gjendesh. Ke harruar se duhet të jetosh për idealin tënd, por njëkohësisht edhe se s'ke humbur përgjithmonë. Se gjërat ndërrojnë.

Pse je tulatur? Ti ke vendosur. Asnjëherë nuk je kthyer nga ai terr që vlen sa për mijëra sakrificat të tjera pa iluzione. Ti vetë e provove. Nga kjo s' del dot. Po me saktësi, s' ke llogaritur dot asgjë. Vetëm e di që kjo do të ndodhë. Dhe se ky është fundi. Po ç' rëndësi ka? Aromën e ditëve të këndshme s' do ta ndiesh më dhe gjithçka do të tjetërsohet në imazhin e mundimit.

Ndoshta zonjushë Evisi kishte harruar se do të vinte një cak. Ajo s' dinte gjë se përpjekjet e tua të kishin çuar në vetëvrasje shpirtërore. Edhe pse ishte qendra e këtij çasti kritik në kufijtë e marrëzisë.

A duhet të harrojnë njerëzit se mbi jetët e tyre ka dhe të tjera jetë, se ka dhe njerëz që nisen drejt fatalitetit nën tingujt e muzikës? Ç' ka këtu të pakuptueshme? E largët për shpirtrat që vuajnë apo që i largohen asaj? Ç' ka të panjohur brenda njohjes apo lindjes brenda vdekjes? Vrasësit s' janë asgjë tjetër, veç njerëz që humbasin kurajën. Apo kurajën që ia vlen të sakrifikohet? Ndërsa njerëzimi tregohet mospërfillës përpara njerëzve që vriten për hir të tij. Brenda këtij njerëzimi kemi të veçantët që s' mund të durojnë atë ëmbëlsi, ndaj ngrihen mbi veten, pa dyshim duke u ankuar në deklaratat të panjohura për ne. Dhe Evisi vështronte, buzëqeshte, buzëqeshte dhe largohej në lumturi të plotë. Ndoshta kurrë s' e shijoi atë shkatërrim të përsosur. Ndoshta kishte të drejtë të fluturonte. Ndoshta kërkonte të vinin kohërat e duhura. Të mos të të prekte bukurinë magjepsëse. Por kur s' e njeh përrethësinë, ç' mund të gjesh më tej? Sigurisht që s' ka fitore, megjithëse kujton se e ke në dorë. Pafajësia është aq e fajshme sa dhe vetë fajësia përballë së pafajshmes. Është e çuditshme që një tru të shkatërrohet aq lehtë. Jo. Nuk është e vërtetë dhe është e vërtetë aq sa ajo s' mund të jetë. Botët, sado që të ndërthuren, kurrë s' kanë

për t'u përputhur. Gjithmonë ka vend për dallime, se lotët vijnë nga kundërshtia. Po a vjen kundërshtia nga pesimizmi dhe pesimizmi nga?...

O, stacione të pafundme, vendosni një vendstacion! Aromat largohen përballë klithjeve dhe ju s'ktheni asgjë. Vetëm bindja është ajo që në çastin e fundit kërkon përmbysjen e botës. Sikur gjithësia të ngrihej kundër asaj që s'mund të vritet, asgjë s'ka për të bërë. A nuk është e përbindshme që ta bëjë këtë një njeri i vetëm, që, pa e ditur se ç'po ndodh, është futur në të padukshmen? Dhe udhëtimi vazhdon. Tronditje. Imagjinata. Në një çast shpirtra që presin tmerrin dhe shpirtra që përgatiten për lumturi. Dhe s'dinë asgjë. Dhe dinë gjithçka, në përmasa të pamëshirshme, në çaste që as njerëzimi vetë s'njeh caqe të tilla. Brenda një njeriu të vdesin dy njerëz dhe vazhdojnë t'i buzëqeshin dëlirësisë. Ngritje për sakrilegj? Jo. Por dhe mund të pohosh. Dhe as që mund të mendosh. Ajo ka ndodhur. Askush s'ka sy ta shikojë. Si është e mundur? Sakrilegj? Jo. Kurrë? Kurrë. Është e vështirë të shikohet atje ku ka skëterrë. E pamundur. Të këtë ndodhur vallë? Shpejtësi që askush s'merr përsipër ta llogarisë. Mjekët e kanë rrethuar. Fytyra të vrenjtura. Ata duan ta pyesin. Askush s'jep shpresë dhe as që mund të shpjegojnë diçka rreth jetës së tij private. Ose thonë gjëra pa kurrfarë rëndësie. Në sytë e tij sërish fillesa lotësh. Qetësi mortore. Një dorë, që kërkon një penë për të shkruar diagnozën. Dikush hedh vështrimin mbi të. Dora tërhiqet. Bëjnë me shenjë të dalin. S'përcaktohet? A thua se s'munden? Por të gjithë e kuptojnë se është vonë. Vonë.

Në kohën kur mjekët përcaktuan përfundimisht gjendjen tënde, njëri prej shokëve u drejtua për në hotelin e zonjushë Evisit. Pas lajmërimit, për të zbritur poshtë në holl, ajo nuk



u vonua, pothuaj as edhe një minutë. Atë çast ajo u përhumb, ndërsa ai i komunikoi me një dhembje të pashtershme lajmin. “O, Zot, a ishte e mundur? A ishte e vërtetë? O, perëndi, ç’gjë të kobshme solle? Pse s’e përmbyste botën?”, thoshte shprehja e fytyrës së saj. “Njeriu, i cili ju donte tmerrësisht, - i tha ai, - s’mund t’ju shohë më. Mjekët përcaktuan se gjithçka është e pamundur. Sesi ndodhi kjo gjë dhe në ç’mënyrë s’mund t’ua shpjegoj dot, vetëm mund t’u them se para largimit nga kryeqyteti, që ishte i papritur për ne, tha se do të pushonte disa ditë në qytetin e tij. E gjetëm në një dhomë të mbyllur me një muzikë dhembjeje. Unë e pyeta disa herë për ju, por ai nuk dha ndonjë shenjë se ju kujtonte. Shpeshherë i rrëshqisnin lot pavetëdijeje dhe vështrimi i kishte humbur çdo lloj mprehtësie të mëparshme. Dua të them se vetëm ti mund ta kishe shpëtuar nga shkretëtira. Duhet ta kuptosh çdo të thotë humbja e njeriut që kishte pësuar aq shumë depresione shpirtërore, që luante me jetën e tij për lumturinë tuaj. Tani ai tha lamtumirë njëherë e përgjithmonë. Kurrë më..., kurrë më nuk do të vijë”.

Nga sytë e zonjushë Evisit kishin rrëshqitur pika lotësh, që po zbrisnin mbi mollëza. Ç’do të thotë të jetosh të tmerrshmen? Të gjitha ato që i dukeshin dikur aq të largëta, ja, ku ishin, kishin ndodhur.

Pas tri minutash, tek ishte në dhomën e saj dhe po shihte nga dritarja në bulevard, diktoi siluetën e hijes sate. U shemb në vend pa ndjenja. “A jeni njerëzore? A jeni njerëzore?”, dëgjoi ajo. Askush nuk thërriste. Po ky ishte zëri yt. Ah, sikur... ah, sikur! Jo. Kurrë më... Kurrë më.

*Tiranë, 1993*

## PARANDJENJA

Parandjenja është ajo që më ka shqetësuar më tepër në jetë. Dhe, çuditërisht, megjithëse jam munduar t'i shmangem, kjo ka qenë e kotë. Isha me të vërtetë një i marrë, për më tepër, kur mendoja se ikja ime nga spitali nuk kishte ndonjë shkak. Të them të drejtën më shkrepni aq befasisht, sa gjithkush nuk do ta besonte. Ishte pasdite dhe, pas afërsisht njëzet e katër orësh do të gjendesha në sallën e operacionit, e cila herë më frikësonte dhe herë sikur më shndërronte të tërin. Nëse do të ishte ky një prag, pse duhej të ngrihesha thujt krejt i qetë dhe, pasi të vishesha, t'ia mbathja këmbëve? Ku do të shkoja? Më mirë le të nisemi.

Sa u gjenda në korridorin e gjatë të pavijoneve, provova një ndjenjë mes habitës dhe naivitetit të lëkundshëm. Sikur të më kapnin mjekët, do të isha fatkeq. Ndoshta, do të më fusnin përsëri në dhomë e do të më jepnin ndonjë qetësues, megjithëse nuk kisha kurrfarë gjëje. Patjetër operacioni do të bëhej tashmë i menjëhershëm, pasi nuk do të bindeshin për qëndrimin tim të mëtejshëm atje. Ja, që kemi fat. Ky fat na ka ndjekur pas, më keq se ata qentë e tërbuar, që, po s' shqepën

një copë mish, nuk heqin dorë nga e tyrja. Shpëtova dhe mora autobusin që të çonte në qendër të qytetit. Këtë e dija fare mirë, ngaqë në atë kryeqytet rrugët të çonin vetëm në qendër. I heshtur, sikur të isha zënë rob, po vështroja nga dritarja diku larg. Dhe ndjeva zhbirimet e syve të njerëzve. Atëherë u talla me veten time. Koka ime e pakrehur u kishte dhënë shkas për humor atyre që më rrethonin. Po, fytyra ime ishte me të vërtetë simpatike. Madje, qe bardhësuar, ngaqë më së paku dy javë, s'kisha parë diell me sy. Po aq më bënte, ku e dinin ata se kush isha unë? Edhe sikur ta dinin, rëndësi kishte që do të ndieja orët e lirisë së humbur.

E ndjeva se papritur autobusi po ndalonte. Duhet të zbrisni, thanë. I vetmi shkak ishte ndalimi i qarkullimit. E ç'kryeqytet ishte ky?

Zbrita me ngadalë përmes turmës së nevrikosur. Ç'po ndodhte? Ja që në ato çaste jo vetëm unë, por askush nuk mund t'i përgjigjej kësaj pyetjeje të thjeshtë. Po janë të rralla ato kuriozitetet, që nuk janë shuar. Si të tjerët, bëra për andej nga dukej se po ndodhte diçka. Kjo ishte rruga lindore, që pësonte një kthesë të fortë për në qendër, të cilën e përshkova si i frikësuar. Gjithmonë shtysa ime ka qenë katastrofike. Në të vërtetë s'kishte kohë t'i mendoja të gjitha këto. Por mendimi se në historinë e këtij kryeqyteti, që kurrë nuk ishte bllokuar trafiku më gërvishti në shpirt. “Eh, natyrë pse më bëre kaq të ndjeshëm?!” Le t'i lëmë këto, se ndryshe do të ngatërroj gjithçka dhe hajde pastaj gjeje anën. Po si duhet ta quaj veten, fatkeq apo të lumtur? Këtë s'jam në gjendje ta përcaktoj.

Për një çast, një ulërimë e borive të makinave, si një klithmë e përbindshme, përshkoi qiellin gri në një të kaltër të zbehtë, që po përgatiste mbrëmjen. Ajo m'i ngriti qimet

përpjetë dhe isha gati të qaja. I ndjeva fillesat e lotëve dhe me një përpjekje, që s'do ta kisha bërë kurrë, i mbajta. Anës rrugës kishte ca pemë, që unë i kisha prekur me dorë instinktivisht. Më në fund, ia ngula sytë një gruaje me makijazh tepër të rënduar. Ajo sikur m'u përkushtua nga ngulimi im krejt i zbrazët. Duhej të pyesja se ç'po ndodhte. Ja, që për një çast harrova. Ndoshta, edhe ekzistencën time përpara kësaj gruaje të lirë, siç dukej në vështrim të parë. Ajo, krejt e shkathët, si në përgjigje të pyetjes sime të heshtur, më tha me atë qëndrimin e saj kryekëput absurd: "Kanë vrarë një njeri". Sikur t'ia kisha dhënë një të qeshure atë çast, sot nuk do të isha gjallë. Për këtë ju siguroj. Nga kjo grua nuk do të pësoja gjë, madje do ta doja mbase më shumë, por nga përrethësia që mbushte bulevardet do ta kisha pësuar keq.

E, nëse do ta analizonim me hollësi më të madhe, do të thoshim: "Kaq i rëndësishëm qenka ky njeri, saqë ia vlen të ndërpresësh gjithçka? Ç'të mira i paska sjellë njerëzimit? Mos vallë përbën ndonjë veçanti me vlera të pakonceptueshme? Ah, sikur të dihej e vërteta! Le që ç'na shtyn ne që ta mësojmë? Mos vallë duhet të hamë ndonjë plumb kot së koti? Eh, frikë, frikë! Pa ty, sot as gjysma e njerëzve nuk do të ishin".

Gruaja më kishte kapur për dore dhe unë u ndjeva si një fëmijë njëzetvjeçar nën mbrojtjen e saj. Në atë kohë, pothuajse paralel me ne, një makinë e zezë po çante përpara me një shpejtësi edhe më të vogël se një hap i zakonshëm.

Pas saj, ca vetura të tjera vazhdonin ulërimën e tyre therëse dhe paralajmëruese. Ato kishin brenda vetëm djem të rinj, që dukeshin tepër të egërsuar. Pamja e tyre të kallte frikën. Dhe shoqërimi ndiqej nga një turmë, ku ishte e vështirë të gjeje një njeri që të mos qante. Atë çast, sa nuk i rashë me kokë trungut

të një peme, po të mos më kishte përmendur gruaja, që më lëshoi një buzëqeshje të dhimbshme. O Zot, na ruaj! A ishin të vërteta këto pamje apo unë isha në një ëndërr të keqe? Ja, e hapën makinën dhe që andej u duk fytyra e një burri. Unë s'e durova dot pamjen dhe gruaja e panjohur më tha: "Mos shih andej". Po përse, përse dola këtë pasdite? Mos vallë ishte krijuar gjithçka enkas për ta parë unë? Të isha me të vërtetë jo i zakonshëm? S'ke ç'të thuash. Një turbullim i habitshëm më detyroi të pyes veten për rastësitë.

Tri minuta më vonë, edhe rrugët, të cilat vinin nga perëndimi, dukeshin që ishin bllokuar. "Kanë vrarë një njeri", ndoshta kështu u kishin thënë dhe atyre dhe ata kishin qëndruar në vend, në nderim të tij, në ceremoninë e ankthshme, që askush s'e merrte vesh.

Qëndroja i bindur pas gruas, në pritje për të kaluar minutat, që të merrja vesh më tepër. Dhe, shpejtësia e veturave u rrit në prag të kalimit të sheshit qendror për t'u futur më pas në rrugën perëndimore.

Po ç'ishte ai imazh misterioz i atij parakalimi të një njeriu të panjohur në histori? Ai makabritet i revoltuar, që lëshonte klithmën e njeriut? Mprehtësia e kujt ishte kjo dhe prej çfarë përbëhej? Ç'vegime e përbënin këtë moment, nëse mund të deshifrohej? Mos demonët e së keqes po kërkonin flatrat e hapësirave?

Gruaja më kujtoi se s'isha vetëm dhe unë u ktheva nga ajo, më se i trishtuar. Ngrohtësia e dorës së saj më përshkoi të tërin dhe sikur më dha një impuls.

Dhe, në mes të kësaj gjendjeje të krijuar, kur unë po provoja një ndjenjë të çuditshme, ajo tregoi me dorë për nga parkimi. E kuptova që aty do të qe parkuar dhe makina e saj. Po kush ishte kjo grua? Ç'vërejtje ajo tek unë që më

kapi për dore? Ku po më çonte? Pse s'e kundërshtoja? Të ishte parfumi i saj, që të linte pa mend apo lëvizja e saj e lakuar dhe e harmonishme. Apo ishte ndoshta më tepër magjia praruese që më afronte? Pastaj unë do të bëhesha operacion. Duhej të kthehesha në spital.

Megjithatë e panjohura sikur të zbavit, sepse me një grua mund të ndodhin të gjitha. Kisha pasur dikur një mendim sikur do të vdisja nga ndonjë femër. Po ky çast s'mund të vinte kaq herët, përpiqesha t'i mbushja mendjen vetes. Njeriu ka shumë për të jetuar, aq më tepër unë që s'kisha jetuar asgjë.

Të ishte gruaja një engjell i ndritshëm që po m'i mbushte dejtë me nxehtësi? Po, në rrugët e një kryeqyteti kisha parë një ngjarje që në jetë do të më tmerronte. Apo unë jepesha pas abstraksionit deri në pakuptimësi. "Ai ishte një vjedhës", i thashë gruas. Ajo më pa me sytë e ngarkuar me rimel, jashtëzakonisht çuditshëm. Dhe unë vura re se si duart po i pësonin dridhje, kurse shpirtin ia kishte përfshirë një shpërthim që mua m'u duk tronditës. Nëse duhej t'u besoja syve të mi, ç'duhej të bëja? Përse qante ajo grua? O ëmbëlsi të harruara, o paradokse, përse nuk fluturuat në humbëtirë e ju të mos mësonit asgjë rreth joshjeve pa fund dhe harmonive të paprekshme?

Si s'e llogarisim kohën?! Edhe dielli duhej të kishte perënduar, madje dhe ne do të kishim bërë dhjetëra kilometra rrugë, kur gruaja kthehet e më thotë: "Po, ai ishte vjedhës". Jo, kurrë nuk do ta besoja. Mos vallë për hirin tim ajo duhej të ma pohonte? Ç'janë ato halucinacione, që i shoqërojnë njerëzit? Të jetë rastësi apo çfarë, oh, si po çmendesha nga lumturia?! Po përsëri të qeshurit nuk ia dhashë. Kishin vrarë një njeri dhe ne ose së paku unë kisha qenë i pranishëm

në ceremoninë e varrimit të tij. Kuptohet në fragmentin e shkurtër që kisha ndjekur nga ai parakalim mortor.

“Oh, zonjë, zonjë”, po thosha me vete. Makina po futej në një lagje të jashtme të qytetit. Filloi radha e gjatë e vilave me një bukuri që të fladiste dhe që të shtynte të harroje. Peizazhi ndërrohej dhe unë, nën reflekset e zbehta të dritave, herë vëreja jashtësinë dhe herë gruan. Dhe ja, makina ndaloi para një dere të madhe, e cila u hap pas rënies së borisë së makinës. U gjendëm në një garazh të nëndheshëm. Unë kujtova errësirën që të tmerron dhe prapë u mundova të mos tulatesha. U futëm në një dhomë të këndshme ku dhe vdekjen po të gjeje, prapë do thoshe se të kishte ardhur nga engjëjt. Biondina ime enigmatike i tha gruas së shërbimit që të përgatiste gjithçka. Të isha mysafir e të kishin nderin të më prisnin? Po kush isha unë? Po ja, që nganjëherë, vetëm nganjëherë, me pavetëdije u bindemi ca gjërave që edhe më vonë kurrë s’e kuptojmë sesi kanë ndodhur. Ajo u afrua dhe më puthi. Dhe ndjeva fërgëllimën shpirtërore. Ndërkaq, ajo u rehatua pranë meje magjike, e lehtë si pupël, mbështjellë nën atë butësinë që të ngjallte dhembje dhe qetësi. Ja që në botë ka dhe gjëra që luhen para syve tanë. Ishte freskuese ajo muzikë që vinte nga dhoma tjetër. Po dhe gruaja ishte si e lëngshme. “Të vëreja, zotëri, dhe e kuptova që ishit një i huaj në këtë kryeqytet. Të them se më mjafton vetëm kaq, do të thotë se s’po them të vërtetën. Po ti nuk qaje, kur të tjerët nuk i mbanin lotët, ndaj më duket si një virtyt për të cilin do të më duhet të të flas. Sigurisht që përpjekja ime do të jetë e tillë që mos të të ngatërroj. Të të tregoj pra, se si jam krijuar deri këtu dhe se ç’kam pësuar. Nuk dëshiroj që edhe ti të jesh viktimë e atij labirinti, që s’i gjendet fundi. Po marrëdhëniet mes

njerëzve të duket sikur të dhurojnë nektarin e jetës. Po as që merr përsipër të të zhgënjejë në mendimet e tua. Ju s' do ta refuzoni këtë mbrëmje, apo do të bëni ndryshe? E ndiej melankolinë tuaj dhe nuk dua që pas pak kohe ta shihni jetën si një çmendinë, ku përplasen njerëzit e iluzioneve të mëdha. Sa përfytyrime kanë ndryshuar nga ky realitet! Unë vetë i kam ndryshuar këto, zotëri.

... Erdha nga një qytet provincial, kur isha vetëm shtatëmbëdhjetë vjeçe, e mbushur me ëndrra, në krah të një njeriu që me të vërtetë e dashuroja. Ai ishte aktor dhe atëherë unë i pëlqoja si një bukuroshe e rrallë. S' di si ta quaj atë, që e shijova vetëm pak javë, një fluturim timin drejt asaj që po vdes apo drejt asaj që po përpiqet të ringjallet, për të triumfuar. Më dhimbset jeta e shtypur me këmbë nga këta përbindësia. Dua t' i harroj. Në hapin më të afërt i ndesh dhe prapë trishtohem. Asnjë forcë s' kam për t' i parandaluar. As vetë shoqëritë tona nuk mundin. Që ato s' kuptojnë nuk mund ta themi, sepse këto ndodhin në mes tyre, por është frika e eliminimit. Askush nuk i mbron të pambrojturit. Dhe ata qajnë për vrasësit. Po, për vrasësit. Jeta, kjo shkatërrimtare të buzëqesh për të të trishtuar më vonë. Dhe vorbulla e saj mahnitëse të merr në lumin e kobshëm. Ti kërkon të gjeshe vendin tënd. Mirëpo dikush ka atë shkopin magjik, që të shfaqet përpara dhe kërkon të të sjellë humorin e prishur: 'Vendet janë zënë zotëri/zonjë'. Ndërsa udhëkryqet të presin dhe ti heshtazi në ngritjen tënde përpiqesh që të zbërthesh misterin e botës. Kërkon skutat më të thjeshta dhe ngulmon të dashurosh. Kërkon që të jesh me virtytin dhe shpreson atë që kurrë nuk duhet të shpresosh. Kështu?'

Nuk e di nëse u topita pas këtyre fjalëve që ajo zbrazti përmes një gulshi ngulmues. Kjo grua ndoshta do të më



hante shpirtin. Ç'më duhej filozofia e saj? Unë isha një njeri që kisha dalë për të marrë ajër jashtë dhe kisha thyer rregullin. Unë do të bëhesha operacion. Mos vallë kjo ishte vetëm imagjinatë? Jo. Unë e kisha ndier thikën që më kishte çarë. Po kë vallë? Jetën apo barkun e rënduar të çështjeve pa zgjidhje? Ah, operacioni, më duhej të isha aty, por, ndoshta, nuk do të shkoja. Diçka që duhet bërë, po pse ta pësosh më vonë? Megjithatë, le të shpresojmë që të mos kemi të bëjmë me një operacion të dyfishtë, të ndërthurur çuditshëm. Ja, hapet dera dhe tabakaja e përshëndetjes sikur të ngroh. Sikur futet një ndërmjetëse që gjykon gjendjen tonë. Si një shpupuritiqe ëmbëltuese që të zgjon nga ëndrrat.

“Duhet, - vazhdoi ajo, - por s’ mund të bërtasësh që e gjithë bota ta marrë vesh. Të kishe mundësinë, por s’ mundesh. Po ja, që duhet jetuar, po si vallë? E sërish thua se s’ është e mundur. Oh, pamundësi, shembi muret e tua të forta, por në fakt, ti vetë duhet ta bësh këtë. Ky është misioni yt dhe ti ndien se zëri yt ka nisur në heshtje fluturimin e tij për të arritur aty ku ti mendon se s’ka asnjë mundësi, se s’ka asnjë alternativë tjetër”.

Vështrimi i gruas më detyroi të përqendrohem. Ai më sodiste me habitje me një rreze zbehtësie. Dhe sigurisht fladitja e saj sikur kërkonte të më përpinte. Sa e sa duhet të kishte kaluar ajo? Po pse t’i futesha kësaj, kur vetë ajo priste të mbushej me frymë.

“Jam futur në zbërthimin e të paqenësishmes, duke pritur me ankth të papërkulur zgjidhjen e saj. Nuk e kam kuptuar ose, më e drejtë të thuash, s’kam dashur ta kuptoj se ky kryeqytet është mbushur me të mjerë. Të tillë dhe kaq shumë s’do t’ju kenë parë sytë kurrë. Ah, zotëri, e kush nuk do të kishte dëshirë të shihte një rezultante që të jepte zhdërvjelltësi. Shoqëria do të hiqte prangat e së

mjerueshmes. Në rrugë s' do të kishte njerëz të frikësuar nga falimentimi, nga një falimentim i përgjithshëm. A i patë se si vërshonin taksitë me boritë e tyre paralajmëruese? Kush mund t'u dilte përpara dhe t'i ndalonte? Në botë s' është parë kurrë një manifestim për vdekjen e një njeriu të vrarë pa shpjeguar arsyet e vrasjes së tij. Atje vetëm dihej se dikush kishte dalë para portës së tij dhe e kishte parë tek hynte brenda. 'Ju jeni personi?' 'Po', dhe kishte buzëqeshur në mënyrë të pafajshme. 'Atëherë, urdhëroni'. Arma kishte dalë nga pjesa e brendshme e xhakëtës dhe kishte shtënë. Vetëm kaq. Asnjë shpjegim. Të gjithë njerëzit mbushnin bulevardet. Ndoshta kishin gjetur pak kohë për të pushuar. Dhe ja, ku atyre iu ngritën qimet përpjetë. S'ka dyshim që buzëqeshja do t'u jetë shuar në buzë. Ju ndoshta s'i keni parë rrezatimet e vdekjes. As përsosmërinë që luhatet ndërmjet të vërtetës së hidhur dhe poshtërsisë së korruptuar. S' do t'u pëlqejnë më lulishtet, ku mendohet se ka freski dhe prehje. Jam e bindur, zotëri. Tani po na pret një darkë e këndshme. Unë shoh se në trurin tuaj kanë shpërthyer iluzione të rëndësishme. Ata po harbojnë. Egërsira. Një fjalë e pa analizuar, të cilën e ndesh kudo. Dhe nuk marrim përsipër këtë analizim, por kërkohet diçka ku nuk është i mundur depërtimi".

S' dua të them se ajo që po ndodhte me mua ishte një shndërrim i plotë. Po veten e ndjeva të pakufizuar. Ja që askush s' të lë të shikosh më tej. Truri të shpëstillet dhe ndjenjat sikur ulërijnë. Po, tamam, ulërijnë për t'u çliruar nga ndjenjat normale, të përditshmet në një anormalitet të momentit. Nëse do të na pyesnin për përrethësinë, do t'u thosha pa asnjë hezitim për këndelljen që po përmbushej skajshmërisht. S'kishte kufizime, as rregulla që të parandalonin. Gruaja po

shëtiste nëpër dhomë. Si mund mos të të shpërqendronte? E lehtë dhe përkëdhelëse, më qëndroi përpara me atë buzëqeshjen që kurrë s'e kisha ndeshur në jetë. Ajo ma mbylli gojën, duke m'i puthitur fort buzët e saj. Atëherë më shkrepiti një mendim, që më bënte të urreja veten. Mirëpo na mungojnë të gjitha forcat për kundërshtim. Mos ajo po tallej kaq hapur? Ku qëndronte filozofia e saj? Ja, që brishtësia dhe hajthmëria ime kishin fluturuar në mënyrë të pakthyeshme. A s'kisha ikur dhe unë vetë si rebel nga spitali?

Shampanja, kjo mjegulluese e shpirtit po na turbullonte. Ajo nisi të zhvishej. Zbërtheu pjesën e përparme të gjoksit. Iu afrova. Çuditërisht u largova. Ajo ishte një vegim. Kush mund të më bindte se jo? Kush mund të më thoshte se nuk ishte një perëndi? Unë do të lëshoja me mijëra deklarata për të. Sikur gjithë bota ta merrte vesh se unë njëzetvjeçari ndodhesha para një të përdale që po më dehte, s'do të pendohesha kurrë. Qëndroi në fund të dhomës e lakuriqësuar, e lartë, e paarritshme, e pakapshme, përtej misterit dhe me një ton gati urdhërues tha: "Hani, zotëri! Vetëm atëherë do të pimë bashkë. Dhe mos harroni virtytin!".

Desha të qaja. Ndjeva mjerimin që përshkonte jetën time. Kujtova rrugët dhe marrëzitë. Kujtova atë që edhe vetë s'e dija se ç'ishte. Ku e kishte fillesën? Sa do të zgjaste? Rrëshqita për të mos u ngritur më. Ajo s'ishte një lëvizje mekanike. Ishte një kozmogoni.

O përqaftime, përse s'u tjetërsuat? Më mirë të ndieja goditje në barkun e mavijosur sesa t'ju ndieja ju. Të prisja më se i poshtëruar.

O ngashërime, pse sollët dëshpërim dhe dashuri? O grua, ç'symbolizojë në përvijimin tënd kureshtar? Ç'ndërthurje përpara botës? Ç'doje të tregojë me forcat e zhveshjes? O

përdalësi. O pafundësi. Dhe ndodhën mes nesh proceset fiziologjike apo filozofike?

Po, sikur e tepruam me vërdallisjen tonë. Jo. Mos vallë harruam se ndërkaq kishin vrarë një njeri? Mos vallë ne u dhamë vetëm pas ledhatimeve? Sa do të zgjaste kjo? Sërish do të ndienim, do të shndërronim përfytyrimet, do të krijonim mosbesim? Do të nisnim filozofimet dhe unë përsëri do të pyesja veten se çfarë ishte kjo dalldisje? Çfarë ishte vallë?

Gruaja ishte ngritur përgjysmë dhe më vështronte. Në mes të dhomës një tavolinë që tregonte parregullsi. Aty-këtu mbetjet pas ngrënies. Dhe unë që ndoshta i duhesha për të mbushur boshësinë. Ndoshta për të kujtuar se humori do të prishej pas pak. Ajo vazhdonte të më përkëdhelte sikur të ma largonte imazhin e dashurisë së çmendur. Unë mundohesha të buzëqeshja. Ajo mbushej me frymë dhe hiqte në zemër. E kuptoja se do të fillonte të fliste. Sa çudi. Po më afrohej ora e operacionit. Po, përsëri, përsëri. Mos vallë tani duhet ta dëgjoja vetëm për një natë dashurie. Harrova t'ju them: kjo ishte nata e parë që flija me një grua, me një grua që s'e mora vesh se ç'lloj gruaje i përkiste. Në shpirtin e saj kishte diçka të ndrydhur, të vetmuar, të largët dhe arratisëse. Diçka që ishte mes një perëndimi dhe një lindjeje.

“Janë pikërisht ato ndërlikime që ti djalosh nuk arrin t'i perceptosh deri në hollësi. A nuk dukej si diçka madhështore?! Ata i kishin përshtatur në mënyrë absolute. Sigurisht që qëllimi i tyre ishte për të fshehur fajin. Ata do të kapin vrasësin e tij duke e quajtur kriminel. E dinë se është i pafajshëm, po ç'kuptim do të kishte kjo? Si do ta mbrojnë ata ekzistencën e tyre dhe ata e dine mirë se po s'e bënë këtë do t'u vijë fundi. Në qiellin e bardhë të jetës duhet të ketë shirita të zinj, simbole të vdekjes. Kënaqen

me torturat çnjerëzore. Ja, zotëri, ja, kush është virtyti. Parakalimi mortar. Vetëm ai i qetëson, u jep frymëmarrjen e lirë për të ngrënë përherë e nga pak jetë njerëzore. Sa e sa herë kam vendosur për t'i dhënë fund jetës. Shpresa pas një dite kaltëroshe më tepër më ka gënjyer me joshjen e saj sesa me paralajmërimin për lumturinë. Ashtu si virtyti, ajo mbeti vetëm një ideal, ku unë mbjell përherë e më tepër dritëzën e tejpashme. Shpesh më duket vetja e çmendur, megjithëse është jeta që më detyron të eci krah për krah vetmisë sime”.

“Të isha pleksur me djallin në një mbrëmje çoroditëse? - pyeta veten. - Çfarë fshihej brenda një gruaje aromatike? Si ta besoja? S’e njihja jetën. Kjo ishte e vërtetë. Faktet nganjëherë janë aq kokëforta, saqë të përmbysin. Aty ndodhin dhe kthesat e mëdha. Mjafton një surprizë dhe ti zë të vështrosh me përhumbje të llahtarshme fundet. Mundohesh t’i shpjegosh. Ajo të kushton sa jeta. Cilën do të zgjidhnit vallë ju, o njerëz? Cilën?”.

E di që kjo pasdite do të jetë më tepër se një thikë në shpirtin tim. Kjo grua, nëse u mundua ta hiqte apo ta ngulte më thellë përbën më tepër një pamundësi. Ndoshta duhet të harroja vetëm për hir të operacionit. Të kesh dëshirë të vdesësh do të thotë që mospëlqimi të ka rrëmbyer. Si t’i jepesh fundit? Sa e sa mund të rithuhet pas kësaj. Ajo tallje të detyron të rezistosh. Dhe ndien mbushjen e gjithçkaje. Vendos ta dallosh. Asgjë nuk të përvijohet qartë.

Në rregull, dukej se qetësia ishte e pathyeshme. Makina jonë po përshkonte me një shpejtësi jo të madhe. Sikur po mbushesha me frymë. Gruas ia pata sqaruar se ku duhej të më çonte. Tani profili i saj i ëmbël më detyronte të hamendësoja gjëra të rrezikshme. As krenaria nuk më jepte ndonjë lumturi të veçantë. Në çast e dashuroja dhe në çast e urreja. Pak më vonë

mbizotëroi ndjenja e parë, tregon se bënte pjesë në ata engjëjt fluturues, të cilëve u priten krahët mizorisht.

Nuk dukeshja i përhumbur, megjithatë, do të ishte e natyrshme të ëndërroja. Askush nuk fliste. Ndoshta duhej të flisnim me veten që ta gjenim atë. Ç’do të thotë të ikësh?

Më thoni diçka që s’ka fund? Nëse çështja qëndron se si duhet të jetë ky fund, sigurisht që do ta presim. Më mirë të ngrihet një pluhur i zi, të na mbulonte, të shndërroheshim në gjithësi.

Operacioni as që më shqetësonte. Le të ishin mbledhur e të më prisnin. Le të më kishin dalë e të më kërkonin. E dija që ata nuk do të më kuptonin.

Kishim ndaluar përpara portës së hyrjes. Një derë e madhe nga ku kaloje në korridorin e gjatë dhe dilje në radhën e pavijoneve. Zbritëm të dy, madje pa e parë njëri-tjetrin. I ngjitëm shkallët krejt të përhumbur.

Ndarja ndoshta do të ishte e pamëshirshme. Dhe kuptova përmasat e zgjuarsisë së saj. Një vështrim si shkrepimim vetëtimash. Dhe bukuria sikur u trishtua, sikur pa tmerrin. Eca, eca në rrëshqitje qarëse. Ktheva kokën dhe pashë që s’kishte lëvizur. Kurrë s’do të largohesha, po qe se ajo do të qëndronte atje. Qava me lotët e vetmisë. Kush mund të më bindte se ajo nuk qante? Të ishte ky një premtim i heshtur? Ajo u kthye dhe iku. Unë e shoqërova. Ishte me të vërtetë pavdekësia? Përpara sallës së operacionit takova mjekun. Në qoftë se kisha pasur forcë ndonjëherë, pa dyshim që ishte ky çast: “Jam gati për operacion”.

Fjalët iu zunë në fytyrën ia mbuloi një zbehtësi tragjike.

*Vlorë, 1998*